

Faza e zbatimit për krijimin e një kampusi të Kolegjit të Evropës në Tiranë**Duration:** 01.05.2024 - 30.06.2027**Countries:**
Shqipëria**EU contribution:** € 1 884 672**Total budget:** € 2 688 672**Implementer:**

EUROPA COLLEGE STICHTING VAN OPENBAAR NUT

**Project description:**

Veprimi mbështet vitin e parë akademik të kampusit të Kolegjit të Evropës në Tiranë, Shqipëri, duke shënuar fillimin e punës së veprimtarisë së institucionit në Ballkanin Perëndimor. Pas një faze përgatitore 16-mujore, projekti tani është plotësisht i angazhuar në sigurimin e zbatimit të qetë të edicionit të parë të Masterit të Arteve në Transformimin dhe Integrimin Evropian (ETI).

Veprimi mbulon disa shtylla kryesore: rekrutimin dhe konsolidimin e ekipeve lokale administrative dhe akademike; marrjen në dorëzim dhe menaxhimin e tre ndërtesave kryesore të kampusit, përfshirë rezidencën studentore; si dhe ofrimin e shërbimeve të përditshme dhe mbështetjes akademike për grupin e parë të studentëve. Gjithashtu përfshin rekrutimin e stafit të fakultetit dhe profesorëve vizitorë, ofrimin e programit akademik dhe organizimin e konferencave, vizitave studimore dhe ngjarjeve për publik.

Paralelisht, kampusi forcon identitetin dhe dukshmërinë e tij institucionale në Shqipëri dhe në të gjithë rajonin, duke ndërtuar partneritete me institucionet e BE-së, autoritetet kombëtare, universitetet dhe aktorët e shoqërisë civile.

Përmes këtyre aktiviteteve, veprimi kontribuon drejtpërdrejt në misionin e Kolegjit për trajnimin e profesionistëve të ardhshëm evropianë dhe në objektivin më të gjerë të nxitjes së mirëkuptimit të ndërsjellë, integritit dhe bashkëpunimit midis Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor.

Expected results:

Zbatimi i këtij veprimi pritet të jep një sërë rezultatesh të prekshme akademike, institucionale dhe operative që do të konsolidojnë themelimin e kampusit të Kolegjit të Evropës në Tiranë dhe sigurojnë qëndrueshmërinë e tij afatgjatë. Këto rezultate pasqyrojnë progresin e arritur gjatë vitit të parë akademik dhe hedhin themelet për vazhdimin dhe zgjerimin e aktiviteteve në vitet 2025-2026.

- Programi Master i ETI-së u përrua, u funksionalizua dhe u zbatua.
- Përsosmëri akademike e vendosur (program akademik i rishikuar dhe i përditësuar plotësisht për vitin e dytë akademik 2025-2026).
- Rrjeti i Alumni-ve të kampusit të Tiranës, i krijuar përmes grupit të parë të të diplomuarve me përfaqësim të barabartë gjinor dhe me diversitet nga Kolegji i Evropës në Tiranë (CoET).
- Grupi i dytë i studentëve dhe pedagogëve të përzgjedhur, me përfaqësim të barabartë gjinor dhe me diversitet, për vitin akademik 2025-2026.
- U përzgjedh fakulteti i dytë i Kolegjit të Evropës në Tiranë (CoET), me përfaqësim të barabartë gjinor dhe diversitet, për vitin akademik 2025-2026.
- Rritja e dukshmërisë së veprimit, si dhe numrit e cilësisë së aplikimeve nga studentë të ndryshëm për vitin akademik 2025-2026.
- Kampusi i përkohshëm për vitet e para akademike është plotësisht funksional.